



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas/Gllogoc
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-22661 dt. 12.05.2023

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z.Milaim Hajdari, me dt. **19.05.2023** (E Premte) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:


Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. **13.04.2023**,
2. Propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollsishëm për Qendren e Qytetit – Drenas/Gllogoc.
3. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
4. Propozim vendim për Rialokim të mjeteve financiare në Sherbimet e Shëndetsisë.
5. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave Vetanake.
6. Të ndryshme.

Drenas, 12.05.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02- Nr. 060-19879 dt. 27/04/2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **13.04.2023**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 17.03.2023, prot. 02-060/04-15371 i dt. 30.03.2023.
2. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga Projekt nr. 10/611/850010/300/53732/0820, Kategoria e Shpenzimeve Kapitale në Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 në buxhetin e drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake .
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Florentina Elezi-Veliu, propozoj që me ndryshu orarin e barnatoreve, për shkak se ka shumë ankesa nga qytetaret, sidomos vikendeve dhe festave nuk po punojnë barnatorët, kërkoj me hy ne rend dite që me zgjatë orarin barnatoreve.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, orarin janë të detyruar me e respektu gjitha barnatorët sepse për ndryshe i dënon inspeksioni, mirëpo do të konsultohemi me drejtorinë përkatëse.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 30.03.2023.**

Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga Projekt nr.10/611/850010/300/53732/0820, Kategoria e Shpenzimeve Kapitale në Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 në buxhetin e drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.**

Florentina Elezi-Veliu, keni kërkuar me u bë transferi i mjeteve 300 mijë euro për objektin sportiv, ndërsa të planifikuara për këtë projekt janë 400 mijë euro, për vitin 2023 janë ndarë 100 mijë euro për vitin 2024 janë ndarë 70 mijë euro dhe për vitin 2025, 70 mijë euro, që në total po i bien 240 mijë euro nëse ia shtojmë edhe këto sot që po dojmë me e bë këtë transfer po i bien 560 mijë euro që i bien 160 mijë euro më shumë se planifikimi që e keni mendu, pse ka ndodh kjo, dhe sa mjete mundeni me i shpenzu brenda vitit.

Agim Kastrati, zyrtar në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, në mungesë të drejtoreshës dha sqarim. Kultura në Drenas ka nevojë për objekte dhe të tjera por njëkohësisht edhe për ngritjen e kapaciteteve të infrastrukturës. Me këtë propozim vendim miratohet transferi i mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale nga projekti nr 10/611/850010/300/53732/0802 “Ndërtimi i qendrave multifunksionale (shtëpi e Kulturës: Muze, Arkiv, Bibliotekë, Teater, Salla Filmi, Galeria e Arteve) Gllogoc, Tërstenik, Komoran në projektin nr/10/611/850010/300/89114/0820 Objekte Sportive, Stadioni i Qytetit- Faza e dyte, në programin buxhetor të drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport. Transferi i këtyre mjeteve behët nga Kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale i buxhetit të planifikuar i drejtuar kulturës, Rinise dhe Sportit dhe Miratuar nga Kuvendi i Komunës në kategorinë për shpenzime Kapitale në projektet me vlerë 300,000,00 €.

Florentina Elezi-Veliu, kërkoj sqarim për 160 mijë euro që janë ekstra planifikimit a është keq planifikim apo nder vite kanë me u bartë diku tjetër apo çfarë?

Agim Kastrati, zyrtar në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, projekti i stadiumit është një projekt kapital i cili kalon vlerën mbi 5 milion euro, dhe jo me këto mjete po edhe 5 herë kaq nuk përfundon për arsye të ngritjes së infrastrukturës dhe kritereve të FIFA-s dhe Federatave për zhvillimin e sportit krijojnë kritere të domosdoshme dhe të barazvlefshme me ato evropiane ndërkombëtare prandaj nuk është një mbulesë vetëm një vazhdimësi e kryerjes së projektit që vetëm e përshpejton procedurën por edhe investimin kapital në atë projekt.

Pas diskutimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 05 vota (Për), kundër nuk pati, 2 vota abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake .**

Shyqiri Bublaku, Drejtor i Financave- sa i përket raportit për bartjen dhe të hyrat vetanake gjatë vitit 2022 ne kemi pasur ne kemi pas një tejkalim të realizimit të hyrave vetanake dhe ka qenë një shumë bukur e mirë në vlerë prej 1,146,544.88 euro, në trendin e rritjes të hyrave vetanake kanë ndikuar edhe gjobat e gjykatave dhe gjobat e komunikacionit kanë ndikuar dukshëm në rritjen e kësaj shume, pastaj i kemi edhe mjetet e të hyrave vetanake të vitit 2022 që duhet të barten nga fondi janë në shumë prej: 270,627.97 dhe nga fondi burimor në shumë prej: 207,435.27 këto mjete i kemi rendit sipas kategorive të shpenzimeve kapitale, mirëpo ju njoftoj se kemi pranuar një informatë nga Drejtoria e Arsimit se ka obligime të pa kryera, tani ia tregoj ndryshimet të cilat janë bërë pas pranimit të materialit të juaj ku i kemi dy ndryshime. Totali i mjeteve për rritje dhe bartje, në shumë prej: **1,624,608.12 euro** barten në këto kategori ekonomike:

Mallra dhe Shërbime	406,722.96 euro
Shpenzimet Komunale	24,000.00 euro
Subvencione dhe Transfere	29,853.81 euro këtu është bërë një ndryshim
	29,835.81 euro në vend të asaj që u cek.
Shpenzime Kapitale	1,164,031.35 euro.

Florentina Elezi-Veliu, Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese, për vitin 2023 i keni ndarë 23 mijë euro dhe tani i keni shtu edhe 5,751.00 € a mjaftojnë këto për u përfundua komplet projekti? Tek “Zgjerimi dhe ndërtimi i Sheshit “Fehmi e Xhevë Lladrovci” shuma fillestare që e keni planifikuar ka qenë 900,000.00 € tani për vitin 2023 505,446.00 po e kalojnë këtë vlerën fillestare a dmth që keni ngec në planifikim a çka po ndodh? “Rregullimi i shtratit të lumit Drenica – Verbica”, për vitin 2023 janë planifikuar 30 mijë euro tani i keni ndarë edhe 4,876.17 € a janë shuma të vogla që prap se prap nuk kishi me mujt me përfundu projektin por vetëm i keni shpërnda, a do të ishte ma mirë që më u bart me një projekt ku përfundon të paktën e jo me mbet prap në gjysmë.

Shyqiri Bublaku, Drejtor i Financave- gjatë vitit 2022 ne e kemi realizuar atë shumë 1,146,544.88 euro, në tejkalim të hyrave mirëpo bartja e të hyrave vetanake e vitit 2021, derisa kemi projekt me atë numër që kanë mbet në vitin 2022 duhet të barten, gjelbërimi i qytetit dhe sheshi, kjo nuk dmth që përfundon me ato mjete mirëpo për vitin 2023.

Pas diskutimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Të ndryshme.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sa i përket orarit të barnatoreve nëse duhet të bëjmë propozim vendim për këtë çështje do ta bëjmë dhe nëse jo atëherë ju kthejmë një përgjigje.

Hamit Kastrati, ne si anëtar të kuvendit kërkojmë që të bëhet një komision për pronat të cilat janë dhënë deri më tani deri kur e kanë afatin disa që kanë qenë duke u punu dhe që janë ndal punimet, a kanë ndonjë afat se kur duhet ta lirojnë pronat apo por çfarë i kanë marrë pronat?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, në ueb faqe të komunës janë të publikuara dy komisione të cilat janë të formuara për këtë qellim dhe të cilët e kanë për obligim me raportu për çdo gjashtë muaj, komisionet janë duke punuar dhe asnjë gjë ende nuk i kalu limitet apo afatet. Objektet të cilat nuk janë përfundu ju kemi dhënë afat në bazë të rekomandimeve, komisioneve ju kemi dhënë afat edhe për gjashtë muaj.

Hamit Kastrati, a duhet me e pas një raport ne si kuvend?


Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne raportojmë për gjithë punën e kryetarit çdo gjashtë muaj edhe ne vit dhe gjitha i keni në raport.

Azmine Gjoka, pati një shqetësim lidhur me çështjen e ujit të pijes a ka ndonjë lëvizje sepse po e shoh që nuk keni ndarë asnjë mjet lidhur më këtë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne e kemi fol dhe kemi thënë për projektet që janë duke u zhvilluar nuk kemi asnjë nevojë me shtu mjete shtesë për sistemin e ujit të pijes sepse është në proces, nuk kemi të parapamë tani me bo diçka, pjesa që na takon neve si komunë jemi duke e kry ndërsa pjesa që i takon kompanisë të ujësjellësit, ne i kemi mjet për ato që i kemi ne proces.


Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroi të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoi rreth orës 10:40 min .

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01-Nr 400/01-22196 dt. 11/05/2023

Në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 paragrafi 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Glllogocit, në bazë të nenit 5 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.3, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR QENDRËN E
QYTETIT-GLLOGOC

Neni 1

Miratohet vendimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit-Glllogoc.

Neni 2

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo rurale, siç është përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

Neni 3

Zona për të cilën do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm është Qendra e Qytetit Glllogoc dhe përfshinë një sipërfaqe prej $S=110.00$ Ha.

Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 5

Autoriteti për planifikim hapësinor është përgjegjës për zbatimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në bashkërendim dhe bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse sektoriale përgjegjëse.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Glllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

 Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2022-2030 të datës 24.06.2022, Komuna e Glllogocit është përcaktuar që përmes Hartës Zonale të Komunës të identifikojë zonat për të cilën kërkohet të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm, me vendim të kuvendit të komunës 02-Nr.030/01-46344 datë 31.08.2022, është filluar me hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc për të përcaktuar kushtet për rregullimin e hapësirave për zonën urbane.

Me Vendimin 02-Nr.400/01-14932 datë 28.03.2023 të kuvendit të komunës, është miratuar vendimi për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc, në mënyrë që t'u lihet në dispozicion qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente për projekt dokumentin Plani Rregullues i Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc.

Shqyrtimi publik i Projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc ka zgjat 30 ditë, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projekt dokumenti së bashku me përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik- raportin, do t'i dorëzohen kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 020/04-22380 dt. 11/05/2022

Në pajtim me nenin 12 pika d, neni 40 paragrafi 40.2 pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 35 paragrafi 35.2 pika c, neni 36 të Statutit të Komunës së Drenasit të datës 16.09.2008, pasi shqyrtoi propozim vendimin për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të formuar nga Kuvendi Komunal më 27.10.2022, në bazë të Rregullores Nr. 02-030/01-38622 të datës 27.07.2022, e cila bazohet në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me xxxx, merr këtë:

PROPOZIM- VENDIM

Për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

Neni I

Kuvendi i Komunës së Drenasit miraton vendimin për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, Komisioni i cili është formuar me vendim të Komunës së Drenasit (më poshtë Komisioni).

Neni II

Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit ka këtë përbërje (sipas renditjes alfabetike):

1. Arben Shala, nga ekzekutivi
2. Beqir Kiqina, nga legjislativi
3. Egzona Tërdevci, nga legjislativi
4. Fatmir Baliu, nga legjislativi
5. Hamit Haxhiu, nga legjislativi
6. Shqipe Hoxha, nga shoqëria civile, dhe
7. Një anëtar nga përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve apo lagjet urbane.

Anëtarët e lartcekur të Komisionit do të kompensohen për punën e kryer me shumën monetare prej 50 (pesëdhjetë) euro për çdo ditë pune duke filluar nga data 27.04.2023, datë kur ka filluar procesi i zgjedhjes.

Neni III

Pagesa për anëtarët e Komisionit bëhet sipas listave të pjesëmarrjes sipas listave të pjesëmarrjes në mbledhjen e komisionit me të cilën evidentohen me nënshkrime dhe verifikohen nga Kryetari i Komisionit.

Neni IV

Pagesa për anëtarët e Komisionit bëhet nga buxheti i Komunës së Drenasit dhe përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Financa, ndërsa për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni V

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në përputhje me nenin 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 8 të Rregullores Nr. 01/2016, për Shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Drenasit.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Me qëllim që procesi të shkojë sa më mirë dhe që të ketë një pjesëmarrje sa më të madhe në numër të qytetarëve nga fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Drenasit, është dashur që mbledhjet të mbahen në mbrëmje duke filluar nga ora 18.30.

Gjithashtu ky proces kërkon mund, kohë, përkushtim dhe angazhime shtesë të anëtarëve të Komisionit dhe vlerësojmë se e tërë kjo ka nevojë për një kompensim të merituar.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400/01-22607 Dt. 12/05/2023

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Neni 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 16, pika 11 të Ligjit Nr.08/L-198 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Kryetari i Komunës së Drenasit propozon që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të aprovoi:

PROPOZIM – VENDIM
RIALOKIM I MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Propozim Vendim për rialokim të mjeteve financiare brenda nënprogramit Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100) dhe kategorisë së Shpenzimeve Kapitale (30).

Neni 2

Rialokimi i mjeteve bëhet nga projekti “Zgjerimi i QMF Arllat”, kodi 52311, në shumën 45,000.00 euro, burimi i financimit Grande Qeveritare (10) në Projektin “Veturë e ndihmës së shpejtë QKMF Drenas”, kodi 53726, burimi i financimit Grande Qeveritare (10), në shumën prej 45,000.00 euro.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci
Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Meqenëse Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës është në procedurë të finalizimit dhe qendra e AMF në Arllat i plotëson kriteret për ofrim të shërbimeve shëndetësore sipas numrit të banorëve resident si dhe duke parë nevojën për vettura të ndihmës së shpejtë të cilat janë tejet të vjetruara dhe jo funksionale, ky projekt të rialokohet për blerjen e një veture.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400/01-22557 dt. 12/05/2023

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2023, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR RITJEN DHE BARTJËN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1

Me këtë Propozim vendim, miratohet rritja dhe bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023. Mjetet për rritje dhe bartje, janë të hyrat vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit të kaluar dhe viteve tjera.

Neni 2

Të hyrat vetanake për rritje janë në shumë prej: **1,146,544.88 euro** dhe të hyrat e pa shpenzuara e që duhet të bartën nga fondi (21) janë në shumë prej: **270,627.97 euro** dhe nga fondi burimor (22) në shumë prej: **207,435.27 euro**.

Neni 3

Totali i mjeteve për rritje dhe bartje, në shumë prej: **1,624,608.12 euro** barten në këto kategori ekonomike:

Mallra dhe Shërbime	406,722.96 euro
Shpenzimet Komunale	24,000.00 euro
Subvencione dhe Transfere	29,853.81 euro
Shpenzime Kapitale	1,164,031.35 euro

Neni 4

Shuma e mjeteve për bartje nga rritja/tejkalmi i realizimit të të hyrave kundrejt planifikimit dhe nga bilanci i pashpenzuar i fondit 21 nga viti paraprak , në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si vijon:

Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në nën programet si vijon:

Zyra e Kryetarit (16001) në vlerë prej:.....	54,391.47 €
Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100) në vlerë prej:	6,528.00 €
Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66310) në vlerë prej:.....	19,938.48 €
Infrastruktura Rrugore(18001) në vlerë prej:.....	12,361.49 €

Administrata (16301) në shumë prej:.....	30,000.00 €
Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik (48001) në vlerë prej:.....	17,000.00 €
Infrastruktura Publike (18161) në vlerë prej:.....	20,000.00 €
Bujqësia (47001) në vlerë prej:.....	32,000.00 €
Arsimi Parashkollor (92210) në vlerë prej:.....	12,242.98 €
Administrat (92005) në vlerë prej:.....	108,642.60 €

Në kategorinë e Shpenzime Komunale në në programin:

Infrastruktura Rrugore (18001) në vlerë prej:.....	24,000.00 €
--	-------------

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në nën programet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001) në vlerë prej:.....	10,485.04 €
Administrata (73010) në vlerë prej:.....	12,083.01 €
Zyra e Kryetarit (16001) në vlerë prej:	617.56 €
Administrata (92005) në vlerë prej:	1,150.10 €

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001) në projektin:

“Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese, druj dekorativ”, kodi (53313) në vlerë prej:.....	5,751.00 €
--	------------

Infrastruktura Publike (18161) në projektet:

“Zgjerimi dhe ndërtimi i Sheshit “Fehmi e Xhevë Lladrovci” Drenas, kodi (49297) në vlerë prej:....	900,000.00 €
“Rregullimi i shtratit të lumit Drenica – Verbica”, kodi (48254) në vlerë prej:.....	4,876.17 €
“Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë si dhe Bytyq, kodi (48646) në vlerë prej:.....	65,752.50 €
“Asfaltimi i rrugës Zabel i Ulët e Epërme, Korroticë e Ulët dhe Epërme”, kodi (48658) në vlerë prej:.....	51,296.90 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Ulët, kodi (48705) në vlerë prej:	5,109.00 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Gllanasellë dhe Godanc”, kodi (48710) në vlerë prej:.....	6,344.14 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Negroc, Kizhnarekë”, kodi (48713) në vlerë prej:	4,669.00 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Shtuticë, Verbovc dhe Polluzhë”, kodi (51323) në vlerë prej:.....	1,933.50 €

Arsim fillor, mesëm i ulët (93000) në projektin:

“Ndërtimi i fushave të jashtme sportive, rrethoja, Gelshani, Xh. Lladrovci dhe D. Drenices”, kodi (53691)....	10,000.00 €
---	-------------

Neni 5

Shuma e mjeteve për bartje nga bilanci i pashpenzuar i fondit 22 nga viti paraprak, në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si vijon :

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet si vijon:

Infrastruktura Publike (18161) në projektin:

“Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit “Fehmi e Xheva Lladrovci”, kodi (49297) në vlerë prej:.....	108,299.14 €
--	--------------

Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në nën programet si vijon:

Shërbimet Kadastrale (65005), në vlerë prej:.....	74,665.68 €
Administrata (16301), në vlerë prej:.....	2,806.42 €
Planifikim Urban dhe Inspeksioni (66310), në vlerë prej:.....	458.52 €
Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100), në vlerë prej:.....	108.00 €
Arsimi Parashkollor (92210), në vlerë prej:.....	15,579.32 €

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në nën programet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001), në vlerë prej:.....	4,168.20 €
Administrata (92005), në vlerë prej:.....	1,349.90 €



A r s y e t i m

Rritja e të hyrav vetanake në shumë prej: **1,146,544.88** euro është si rezultat i tejkalimit të të hyrave vetanake të planifikuara dhe në pamundësi për alokimin e tyre në vitin 2022, janë bart dhe do të perdoren për zhvillimin e projekteve të parapara për vitin 2023, ndersa mjetet e pa shpenzuara në vitin 2022 janë paraparë për mbulimin e projekteve të cilat kanë qenë dhe janë në zhvillim në vitin 2023.